

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Sherbim

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbim mirëmbajtje mjetet, Loti III:Shërbim mirëmbajtje eskavatorët”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):50000000-5

VLERA E FONDIT LIMIT:

- **1,261,037** (një milion e dyqind e gjashtëdhjetë e një mijë tridhjetë e shtatë) lekë pa tvsh

Vlera e fondit limit është përllogaritur bazuar në Ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar Kreu VI “rregulla të përgjithshme dhe përgatitja e procesit të prokurimit”, neni 34 “Përllogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit”, Vendimit nr.285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 12 “Metoda të zbatueshme në përllogaritjen e vlerës së kontratës”. Komisioni i përllogaritjes së fondit limit i ngritur me Urdher Titullari, pasi ka bërë një studim të tregut ka gjetur oferta nga operatore ekonomike që operojnë në këtë fushë dhe ka llogaritur mesataren e cmimit të tregut duke nxjerrë dhe fondin limit për procedurën.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Maliq ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):
Sipas kritereve të përgjithshme të kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të vërtetuar të bilancit për vitet 2023-2024-2025 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, i ndryshuar, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

- i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;
- ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;
- iii) ka, mesatarisht, 50 të punësuar gjatë periudhës kontabël."

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme ,nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, i ndryshuar, (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.2.2 Kopje të deklaratave për xhiron vjetore të viteve 2023,2024,2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

(Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 1 dhe pika 3 ,të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, ku përcaktohet se: " Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike,

kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin 9920 datë 19.05.2008 ,për ”Procedurës Tatimore ”neni 64 Deklarata Tatimore.

” Vendorsja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.3Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore, për vitin 2026 ,pranë njësive të qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitet sipas Ekstraktit të Rregjistrimit Tregtar dhe për vitin 2026(**këstet e maturuara të vitit 2026**) sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Bashkisë përkatëse, bazuar në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimevetë nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

* Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c,” Pasi cdo operator ekonomik duhet të ketë të paguara taksat dhe tarifat vendore prane njësive të qeverisjes vendore.

Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, nga shpallja e njoftimit të kontratës ,ku vlera e kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20% i fondit limit të kësaj kontrate

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin **publik**, operatori ekonomik duhet të paraqesë **vërtetime** të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe **fatura tatimore të shitjes**, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ,ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin **privat**, operatori ekonomik duhet të paraqesë **fatura tatimore të shitjes**, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi,

dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik të deklarojë në formularin përmbledhës të vetdeklarimit se ka në dispozicion për kryerjen e shërbimeve :

- Përkrahje në pronësi ose me qira .

“Nëqë dorë, përparapublikim të menjohet fituesit dëshmues se afatit të ankimit, autoriteti/entiteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provues për vetë deklaratën në formularin përmbledhës të vetë deklaratimit, sipas mëposhtes :

- a. Për piken e shërbimit në pronësi të paraqitet dokumentacioni i mëposhtem
 - Çertifikatë pronësie
 - Kopje hartë
 - Kopje kartele
- b. Për piken e shërbimit me qira të paraqitet dokumentacioni i mëposhtem
 - Kontratë qiraje të vlefshme për periudhën e realizimit të marrëveshjes kuader
 - Çertifikatë pronësie
 - Kopje hartë
 - Kopje kartele

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Autoriteti Kontraktor ka një aktivitet të përditshëm dhe makinat duhet të jenë gjithmonë në gjendje pune për të shërbyer në çdo moment. Defektet e ndryshme që mund të ndodhin mund të jenë shumë serioze të cilat mund të çojnë deri në bllokim të punës. Për këtë arsye, për ne është me shumë rëndësi koha e riparimit të defektit .

2.3.3 Operatori duhet të deklarojë në formularin përmbledhës të vetdeklarimit që ka në stafin e tij të pakten :

- 1(një) inxhinier mekanik

- 1(nje) motorrist,
- 1(nje) xhenerik,

“Nëçdorast, përparapublikimittenjoftimittefituesitdhenisjes se afatitteankimimit, autoriteti/entikontraktorikërkonofertuesittekualifikuar I pari, qëtëdorëzojëdokumentetprovuesepërvetëdeklarimetnëformularinpërmbledhëstëvetëdeklarimit,s imëposhtë :

a. Në lidhje me **inxhinierin mekanik**, kërkohet që, të paraqesë:

- Diplomën përkatëse (kopje e noterizuar)
- Kontratën e punës. (te vlefshme)

b.Në lidhje me **motorristin dhe xhenerikun** , kërkohet që të paraqesë:

- Kontratën e punës. (te vlefshme)
- Certifikate ”Per aftesine profesionale

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit,që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

2.3.4 Një punësim mesatar i të paktën 3 (tre) punonjësish për muajin e fundit.

“Nëçdorast, përparapublikimittenjoftimittefituesitdhenisjes se afatitteankimimit, autoriteti/entikontraktorikërkonofertuesittekualifikuar I pari, qëtëdorëzojëdokumentetprovuesepërvetëdeklarimetnëformularinpërmbledhëstëvetëdeklarimit,s imëposhtë :

- Vërtetim** të lëshuar dhe konfirmuar (me firme dhe vule) nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit.
Dhe
- Listpagesate**konfirmuar (me firmedhevule) ngaAdministrataTatimoretepunonjesvesipasformatitqekerkohetngalegjislacioni ne fuqi per muajin e fundit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet te deklaroje se pika e serviseshte nen mbikqyrje nga nje kompanie sigurimi.

“Nëçdorast, përparapublikimittenjoftimitefituesitdhenisjes se afatitteankimimit, autoriteti/entikontraktorikërkonofertuesittekualifikuar I pari, qëtëdorëzojëdokumentetprovuesepërvetëdeklarimetnëformularinpërmbledhëstëvetëdeklarimit,s imëposhtë :

- Kontrate me 1 kompani sigurimi te vlefshme gjate gjithë periudhes se realizimit te kontrates.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet te deklaroje se pika e servisit eshte e pajisur me sistem kamerash.

“Nëçdorast, përparapublikimittenjoftimitefituesitdhenisjes se afatitteankimimit, autoriteti/entikontraktorikërkonofertuesittekualifikuar I pari, qëtëdorëzojëdokumentetprovuesepërvetëdeklarimetnëformularinpërmbledhëstëvetëdeklarimit,s imëposhtë :

- fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë një sistem sigurie me kamera me qëllim që mjetet të jenë gjithmonë të monitoruara gjatë periudhës së kryerjes së shërbimit.